



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1884 / prot.

Tiranë, më 24/04 /2020

URDHËR

Nr. 245 , datë 24 .04 .2020

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR 263 DATË 17.04.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË LËVIZJES PËR KËMBËSORËT PENSIONISTË, TË SËMURËVE KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN E MJETEVE PRIVATE” TË NDRYSHUAR.

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7 të ligjit nr.15/2016,“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

U R D H Ë R O J:

Në Urdhrin nr. 263 datë 17.04.2020 “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private” të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “ditën e shtunë datë 18.04.2020” zëvendësohet me togfjalëshin “ditën e shtunë datë 25.04.2020”.
2. Në pikën 1/1, togfjalëshi “ditën e diel, datë 19.04.2020” zëvendësohet me togfjalëshin “ditën e diel, datë 26.04.2020”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

